



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 64, datë 4.11.2020

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E
SISTEMIT TË PAGESAVE NDËRBANKARE ME VLERË TË MADHE – AIPS”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të nenit 129, pika 6, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”, miratuar me vendimin nr. 36, datë 03.06.2020, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 19, pas pikës 8, shtohet pika 8/1 me përmbajtje si më poshtë:

“Nëse ka lidhur marrëveshje me një pjesëmarrës operator në sistemin AIPS, për mbajtjen e një fondi garancie si kërkesë e një autoriteti kompetent ndaj pjesëmarrësit operator, pjesëmarrësi shlyerës pranë të cilit do të mbahet fondi i garancisë, e administron këtë fond nëpërmjet një rezerve pranë llogarisë së tij të shlyerjes në sistemin AIPS. Për qëllime të administrimit dhe përdorimit të fondit të garancisë, pjesëmarrësi shlyerës autorizon pjesëmarrësin operator që të urdhërojë veprime të lëvizjes së fondeve nga kjo rezervë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në sistemin AIPS. Autorizimi jepet nëpërmjet formularit në Shtojcën K, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga të dy palët.”

b) Në nenin 20, në pikën 2, në fund të shkronjës “e” shtohen paragrafët vijues me përmbajtje si më poshtë:

“Në këtë rast:

- i. pjesëmarrësi operator njofton zyrtarisht Bankën e Shqipërisë mbi marrëveshjen e lidhur për këtë qëllim;*
- ii. nëse vendoset në marrëveshje se fondi i garancisë që do të mbahet pranë një subjekti që është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, do të administrohet nëpërmjet një rezerve pranë llogarisë së*

shlyerjes së atij pjesëmarrësi në sistemin AIPS në rolin e pjesëmarrësit shlyerës, atëherë pjesëmarrësi operator duhet të autorizohet prej pjesëmarrësit shlyerës që të urdhërojë veprime të lëvizjes së fondeve nga kjo rezervë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në sistemin AIPS;

- iii. autorizimi sipas pikës “ii” të mësipërme, jepet nëpërmjet formularit në Shtojcën K, i cili plotësohet dhe nënshkruhet nga të dy palët;*
- iv. çdo formular sipas Shtojcës K, i plotësuar dhe nënshkruar nga dy palët që kanë lidhur marrëveshjen, dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë nga pjesëmarrësi operator;*
- v. pjesëmarrësi operator duhet të njoftojë zyrtarisht pa asnjë vonesë Bankën e Shqipërisë në rast zgjidhje ose çdo ndryshimi në marrëveshjen me palën për qëllime të administrimit dhe përdorimit të fondit të garancisë, e për rrjedhojë për çdo ndryshim në autorizimet përkatëse në lidhje me shlyerjen në sistemin AIPS, duke njoftuar ndryshimet në marrëveshje, si dhe plotësuar dhe dorëzuar një formular të ri sipas Shtojcës K, për çdo fshirje apo modifikim në lidhje me autorizimin për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie.”*

c) Neni 26 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

- 1. “Shlyerja e një instruksioni pagese kryhet menjëherë pasi ka marrë statusin “i hyrë” në sistemin AIPS.*
- 2. Shlyerja e një instruksioni pagese konsiderohet përfundimtare për pjesëmarrësit urdhërues dhe përfitues që nga momenti i debitimit dhe kreditimit të llogarive respektive të shlyerjeve.*
- 3. Tërheqja e urdhërpagesës nuk mund të kryhet pas shlyerjes së saj, por mund të kthehet me kah të kundërt, iniciuar nga pala tjetër.”*

d) Në nenin 37, pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtje si më poshtë:

“Për qëllime të lidhura me shlyerjen e sistemeve vartëse të operuara nga pjesëmarrës operatorë, nënkategoria “i”, të cilët për arsye të detyrimit që buron nga kërkesa të autoritetit kompetent përkatës, vendosin për mbajtjen e një fondi garancie pranë një subjekti që është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në sistemin AIPS, Banka e Shqipërisë mundëson krijimin e një rezerve për qëllim të administrimit dhe përdorimit të fondit të garancisë në kuadrin e shlyerjes në sistemin AIPS. Kjo rezervë administrohet në sistemin AIPS pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës në AIPS me të cilin pjesëmarrësi operator ka një marrëveshje të posaçme për qëllime të administrimit të fondit të garancisë. Kur konsiderohet e nevojshme nga Banka e Shqipërisë, si dhe bazuar në kërkesa të autoritetit mbikëqyrës të sistemit vartës të operuar nga pjesëmarrësi operator, parametrat e kësaj rezerve konfigurohen në mënyrë që pjesëmarrësi pranë llogarisë së shlyerjes së të cilit mbahet kjo rezervë, të mos kryejë debite të saj, por kjo gjë t’i lejohet vetëm urdhrave të pjesëmarrësit operator përkatës.”

e) Në nenin 51, pika 1 riformulohet me përmbajtje si më poshtë:

“Një instruksion pagese konsiderohet që ka marrë statusin “i hyrë” në Sistemin AIPS kur të ketë kaluar të gjithë hapat e vlerësimit të vlefshmërisë së instruksionit, të filtrimit kundrejt listave të sanksioneve, e të rezultojë i vlefshëm për t’u shlyer, si dhe të ketë gjendje të mjaftueshme në llogaritë përkatëse të shlyerjes së pjesëmarrësve urdhërues për shlyerjen e tij. Në momentin që ka marrë statusin “i hyrë” në Sistemin AIPS, instruksioni i pagesës konsiderohet i parëvokueshëm.”

2. Pas Shtojcës J, shtohet Shtojca K me titull: “Autorizim për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Emisionit, Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, si dhe pjesëmarrësit e sistemit AIPS.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e tij në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

ZËVENDËSKRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Luljeta MINXHOZI

Shtojca K – Autorizim për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie



BANKA E SHQIPËRISË

SISTEMI AIPS

Autorizim për mbajtjen dhe përdorimin e rezervës për fond garancie për shlyerjen nga pjesëmarrësit operatorë

<input checked="" type="radio"/> I Ri	<input type="radio"/> Modifikim	<input type="radio"/> Fshirje
Qëllimi i aplikimit	<input type="checkbox"/> Operim live	<input type="checkbox"/> Test dhe trajnim
Data e aplikimit	__/__/____	
Data e aktivizimit	__/__/____	

(1) Pjesëmarrësi shlyerës	
BIC i pjesëmarrësit	
Emri i pjesëmarrësit	
(2) Pjesëmarrësi operator	
BIC i Sistemit vartës	
Emri i Sistemit vartës	

Palët konfirmojnë se bien dakord si më poshtë:

1. Pjesëmarrësi shlyerës (1) do të pasqyrojë në rezervën për fondin e garancisë pranë llogarisë së tij të shlyerjes çdo kreditim në favor të fondit të garancisë.
2. Pjesëmarrësi shlyerës (1) autorizon pjesëmarrësin operator (2) të urdhërojë në AIPS lëvizje të fondeve për të debituar rezervën e fondit të garancisë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës, në favor të kreditimit të llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësve në AIPS që paraqiten dështues për instruksione shlyerje të sistemit vartës të operuar nga pjesëmarrësi operator.
3. Pjesëmarrësi shlyerës (1) autorizon pjesëmarrësin operator (2) të urdhërojë në AIPS lëvizje të fondeve për të debituar rezervën e fondit të garancisë pranë llogarisë së shlyerjes së pjesëmarrësit shlyerës, në favor të kreditimit të llogarive të shlyerjes së pjesëmarrësve në AIPS për të cilët pakësohen fondet e kontributit të tyre në fondin e garancisë, në kuadër të marrëveshjeve që kanë me pjesëmarrësin operator.

Për pjesëmarrësin shlyerës

Autorizuesi

(Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)

Për pjesëmarrësin operator

Autorizuesi

(Emri Mbiemri / Nënshkrimi / Vula)